



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno / Prudato Received / Delivery	29-07-2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtetja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIK/SHOK	4441/2022		1/6



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.535/2022**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajrakari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi -Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.535/2022 të datës 15.06.2022 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ me adresë rruga \_\_\_\_\_

Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit/Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike “masë disiplinore” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.07.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.535/2022 e datës 15.06.2022 e parashtruar nga ankues**

**II. MBETET në fuqi Vendimi me numër KD.nr.026/2022 i datës 01.06.2022 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.**

**A r s y e t i m**

Ndaj ankuesit \_\_\_\_\_ e punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, sipas kontratës për kohë të caktuar të datës 30.06.2020, është në pozitën “Zyrtar Korrektues”, në Burgun e Sigurisë së Lartë, me datë 06.05.2022 Mbikëqyrësi i Burgut të Sigurisë së Lartë ka iniciuar procedurën disiplinore ndaj ankuesit, me pretendimet me supozim se ankuesi ka bërë shkelje të rregullave të punës nga neni 46 paragrafi 3 pika 3.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, për mos përmbushje të detyrave të punës.

Komisioni Disiplinor me datën 01.06.2022 ka nxjerrë vendimin me numër KD.nr.026/2022, sipas të cilit ankuesin e ka gjetur përgjegjëse për shkelje të rënda disiplinore dhe i ka shqiptuar masën disiplinore “ndalim 20% e pagës për periudhën 1 muaj”.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin me numër KD.nr.026/2022 të datës 01.06.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me datën 15.06.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 3494/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 21.06.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli me datën 27.06.2022, ka pranuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës përgjigjen në kërkesë me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesa e ankuesit e datës 15.06.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Raporti i datës 29.04.2022 nga Konsulta Mjekësore; Ankesa e ankuesit e datës 29.04.2022 e parashtruar për Zv.Ministrin e Drejtësisë dhe Zyrtarit të Inspektoriatit të Ministrisë së Drejtësisë për Shërbimin Korrektues të Kosovës; Raporti mjekësor i datës 28.03.2022; Njoftimi për pranueshmeri i datës 27.05.2022; Vendimi i datës 01.06.2022 i Komisionit Disiplinor; Kontratë pune për kohë të pacaktuar; Përshkrimi i detyrave të punës; Inicimi i procedurës disiplinore i datës 06.05.2022; Raporti i datës 29.04.2022 për mos pranimin e detyrave nga Raporti/Orari i oficerëve për ndërrimin e ditës i datës 29.04.2022; Vendimi i datës 29.04.2022; Vërejtje e datës 06.05.2021; Akt përcjellës i datës 01.07.2021; Vërejtje e datës 10.12.2020; Procesverbali i datës 13.05.2022; Raporti i incidentit BSL-Sulm ndaj stafit i datës 28.03.2022; Ftesë për intervistë e datës 13.05.2022 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa me numër A.nr.535/2022 e datës 15.06.2022, e parashtruar nga ankuesi është e **pabazuar**, sepse:

Me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.1583/20 të datës 09.07.2020 përkatësisht me nenin 4 paragrafin 1 është përcaktuar se: *“Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë”*, nga rrjedh se me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë themelimi, ndryshimi, përfundimi i marrëdhënies së punës si dhe çdo e drejtë dhe detyrim nga marrëdhënia e punës për zyrtarët e shërbimit korrektues i nënshtrohet dispozitave të legjislacionit për nëpunësit civil dhe legjislacionit të veçantë.

Po ashtu Kolegji, me rastin e shqyrtimit të kësaj lënde ka marrë parasysh specifikat e institucionit sikurse edhe çështjen e legjislacionit të veçantë i përcaktuar si në nenin 4 paragrafin 2 nën paragrafët 2.1, 2.2, 2.3, 2.4 dhe 2.5 ku përcaktohet se: *“Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë*

Shërbimi Civil  
Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave

*ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve”.*

Në bazë të shkresës së përgjigjes në ankesë të datës 27.06.2022 e ofruar nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Shërbimit Korrektues të Kosovës, është bashkangjitur edhe shkresa me përshkrimin e detyrave të punës për pozitën të cilën e ushtron ankuesi “Zyrtar Korrektues”, ku ndër të tjera ka përcaktuar se detyrat kryesore për këtë pozitë janë se: “Zyrtari Korrektues është përgjegjës për mbajtjen dhe kontrollin e të burgosurve për pajtim me rregullat dhe dispozitat ligjore të cilat kanë të bëjnë me punën e tyre; Të sigurojnë një ambient sa më të sigurtë për të burgosurit, personelin dhe vizitorët; Mbikëqyrë, kontrolloj dhe monitoroj lëvizjet dhe aktivitetet e të burgosurve brenda dhe jashtë institucionit; Të bëjë verifikimin e sigurisë institucionale, të mirëmbajë sigurinë në institucion dhe jashtë perimetrit si vëzhgim patrullimin sipas nevojës; ... si dhe Zyrtari Korrektues ka për obligim që ti kryej të gjitha punët shtesë më rast nevoje në pavijonet tjera, me urdhër nga Mbikëqyrësi si dhe Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së Mbikëqyrësit të lartë; dhe i raporton Mbikëqyrësit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, pasi ka shqyrtuar shkresën me numër të protokollit 026 te datës 06.05.2022, me të cilën është iniciuar procedure disiplinore ndaj ankuesit, me pretendimet se ankuesi supozohet se ka bere shkelje të rënda serioze të detyrave të punës, raportin për mospranimin e detyrës nga ankuesi te datës 29.04.2022 nga Mbikëqyrësi i Ndërrimit në Burgun e Sigurisë së Lartë si dhe orarin e oficerëve për ndërrimin e ditës së datës 29.04.2022, ka dëgjuar dëshminë e ankuesit dhe provat tjera të paraqitura, me datën 01.06.2022, ka nxjerr vendim numër protokollit 026 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore „*ndalim i 20% e pagës për periudhë një(1) mujore*” me arsyetimin që nëpunësi ka kryer shkelje disiplinore nga neni 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 dhe 3.8 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë .

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka analizuar vendimin e komisionit disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ku për rastin e ankuesit ka elaboruar veprimet përgjegjëse të ankuesit ndërlidhur me refuzimin e punës nga ana e ankuesit, ku ndër të tjera thuhet se: “*Veprimet e ka rrezikuar institucionin me mos pranimin e detyrës, duke mos respektuar urdhrin e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, lidhur me arsyetimin se ka qenë jo mire, i njëjti nuk ka deklaruar ne Intervistën e mëngjesit se nuk është i gatshëm për punë dhe Mbikëqyrësit i ka kërkuar të mos shkoj në vend punimit tango, (kull vrojtuese), për çka ne rastin konkret refuzimi i vend punimit dhe mos deklarimi me shkrim i arsyeve potenciale për lirim edhe nga detyra paraqesin sjellje te paligjshme ne kuptim te nenit 46 paragrafi 3 pika 3.3 te Ligjit për Zyrtar Publik”, po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave lidhur me këtë çështje nga ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 15.06.2022 i cili ka theksuar se: “*.... me arsyetimin se tash e 2 muaj si pasojë e inateve që kanë ndaj meje udhëheqësit e Burgut të Sigurisë së Lartë më kanë lënë në atë pikë vazhdimisht, edhe pse sipas rregulloreve të punës së SHKK është e lejuar ndërrimi i pozitave*”, andaj Kolegji ka konstatuar se lidhur me këtë pretendim ankimor të ankuesit*

se caktimi për kryerjen e detyrave të zyrtarit korrektues ne pikën vrojtuese të tango 5 i është bërë me tendencë (inate) nuk janë të bazuara dhe nuk qëndrojnë sepse duke u bazuar në provat e lëndës konkretisht në bazë të orarit të oficerëve për ndërrimin e ditës së datës 29.04.2022, dhe raportit për mospranimin e detyrës nga ankuesi te datës 29.04.2022 të Mbikëqyrësit të Ndërrimit në Burgun e Sigurisë së Lartë ankuesi është caktuar që ti kryej detyrat në pavijonin TANGO-5 por që i njëjti ka refuzuar vendin e punës duke theksuar se: *“se pse më këni qit në tango unë nuk e pranoj detyrën”* ndërsa Mbikëqyrësi i Ndërrimit në Burgun e Sigurisë së Lartë i përgjigjet *„se oraret nuk i përpilon ai por Zyra e Personelit”*. po ashtu Kolegji ka konstatuar se ne liste është shënuar se ankuesi ka refuzuar vendin e punës, ndërsa me tutje Kolegji konstaton se orari është aprovuar nga Udhëheqësi i Sigurisë si dhe ne fund të listës së orarit është theksuar se: *“Ndryshimet në orar konsultohen dhe arsyetohen me udhëheqësin e sigurimit”* andaj Kolegji konstaton se ankuesi me asnjë provë nuk ka dëshmuar se caktimi në pikën vrojtuese tango 5 është bërë për çështje tjera personale, andaj mbi këtë bazë, Kolegji konstaton se vendimi i komisionit disiplinor është i bazuar ngase ankuesi me rastin e mos përmbushjes së detyrave të punës është përgjegjëse për shkeljet e kryera, ashtu siç përcaktohet në nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 dhe 3.8 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *Shkelje të rënda konsiderohen: “moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale” dhe 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi;*

Me dispozitat të nenit 48 të Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtarët Publik si dhe nenit 11 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, janë përcaktuar kompetencat e Komisionit Disiplinor, si në vijim:

*“1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca:*

*1.1. bene shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura;*

*1.2. përcakton dhe shqipton masën disiplinore”.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Komisioni Disiplinor, ankuesit i ka shqiptuar masën në proporcion me përgjegjësinë disiplinore dhe me rastin e shkeljes së rëndë të detyrave të punës siç përcaktohet me nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik ku thuhet se: *“1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil”* ndërlidhur me nenin 48 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor”*, nga ku rrjedh se Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të kësaj mase disiplinore për ankuesin, i ka marrë për bazë parimet e individualizimit të masës, veprimet e tjera të mëhershme me qëllim kufizimit të dëmit, andaj bazuar në të gjeturat dhe konstatimet e pasqyruara si më lartë, pretendimet e ankuesit janë të pabazuara në ligj dhe njëkohësisht të paqëndrueshme.

Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në të gjitha provat e lëndës dhe deklaratimet e lartcekura, ka konstatuar se ankuesi me veprimet e tij ka bërë shkelje të detyrave të punës të përcaktuar me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe aktet

nënligjore për zbatimin e tij në fushën e disiplinës, për më tepër zyrtari publik në rastin konkret ankuesi nuk i është përmbajtur detyrimit për respektimin e ligjit, siç parashihet me nenin 25 paragrafit 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"1. Zyrtari publik detyrohet të respektojë Kushtetutën dhe ligjin dhe të mbrojë interesin e shtetit dhe të drejtat dhe liritë e njeriut, 2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike",* po ashtu zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit siç parashihet me nenin 26 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa sipas nenit 28 të këtij ligji, *zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij.*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës në rastin e shqiptimit të masës disiplinore *„ndalim 20% e pagës për periudhën 1 muaj”,* me arsyetimin që nëpunësi ka kryer shkelje disiplinore nga neni 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 dhe 3.8 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 50 të Ligjit nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: *"1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit"* dhe *2. "Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer",* sepse janë shqyrtuar të gjitha provat dhe faktet duke vlerësuar edhe rrethanat rendues dhe lehtësuese, si dhe rrethanat e tjera gjegjësisht masat e tjera disiplinore pasi që ndaj ankuesit Komisioni Disiplinor me datë 29.04.2020 ka marrë vendim me numër protokolli 263 me të cilin vendim ankuesit iu ka shqiptuar masa disiplinore "Qortim" ndërsa më datë 10.12.2020 dhe 06.05.2021 nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ankuesit iu është shqiptuar "Vërejtja", andaj në këtë rast masa e shqiptuar nga Komisioni Disiplinor *„ndalim 20% e pagës për periudhën 1 muaj”,* është në pajtim me nenin 47 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Ligjit nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se *„Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj”,* kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.535/2022

**Avdyl Bektashi**

*Bektashi*  
Procesmbajtës

**Malsore GASHI/BAJRAKTARI**

*Gashi*  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

